



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 25, datë 10.11.2014

PËR

**“MIRATIMIN E TREGUESVE EKONOMIKË DHE FINANCIARË TË BASHKISË SË
TIRANËS DHE TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM PËR PERIUdhËN 2015-2017”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/III/c dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, (i ndryshuar); ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Financave nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”; udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 7, datë 28.02.2014 për “Përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017; udhëzimit të Ministrit të Financave nr.7/1, datë 28.02.2014 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, si dhe të shkresës së Ministrisë së Financave nr.prot 2650/4, datë 11.03.2014 pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë treguesit ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2015-2017, sipas lidhjes nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2015-2017, sipas programeve dhe për çdo njësi shpenzuese, sipas lidhjes nr.2 dhe lidhjes nr.3, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja, njësitë bashkiake dhe të gjitha strukturat dhe ndërmarrjet në varësi të Bashkisë së Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI